



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/20

Datë: 24.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e fushës për Ndërmarrjet Sociale.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Ministarstva Rrada i Socialne Zastitne -*  
*Ministry of Labour and Social Welfare*

**KONCEPT DOKUMENT**  
**PËR RREGULLIMIN E FUSHËS PËR NDERMARRJET SOCIALE**

## 1. Hyrje (Dokumentet ndërlidhëse)

Ekonomia sociale dhe në veçanti ndërmarrjet sociale kanë marrë një rëndësi të madhe në Europë gjatë dy dekadave të fundit. Ekonomia sociale ka lindur dhe po zhvillohet brenda ekonomisë së tregut me qëllim që t'ju vijë në ndihmë nevojave sociale të individit dhe shoqërisë. Ndërmarrjet sociale janë instrumentat e promovimit të ekonomisë sociale. Ndonëse nuk ka një përkufizim të vetëm të gjithëpranuar të ndërmarrjes sociale, ato konsiderohen si një bashkim i promovimit të vlerave sociale me sipërmarrjen e lirë. Ndërmarrja sociale kryen veprimtari ekonomike por nuk themelohet me qëllime fitimi. Ajo themelohet për të përmbushur objektiva sociale që lidhen me integrimin në punë të personave të disavantazuar, ose me ofrimin e të mirave dhe shërbimeve në dobi të shoqërisë.

Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale në Evropë është ndjekur nga një numër i madh studimesh dhe analizash mbi modelet dhe funksionet e ndërmarrjeve sociale si edhe me avantazhet që ato kanë në ekonominë e tregut. Vitet e fundit edhe Bashkimi Evropian ka ndërmarrë disa nisma për zhvillimin dhe promovimin e ndërmarrjeve sociale në Evropë. Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale, si një element kyç i ekonomisë sociale, është pjesë e Strategjisë Evropa 2020. Me qëllim promovimin e një "ekonomie të tregut social", Bashkimi Evropian ka vendosur ekonominë sociale, si instrument të ri në qendër të shqetësimeve që lidhen në veçanti me luftën kundër varfërisë dhe përjashtimit social si edhe krijimin e vendeve të punës. Vizioni dhe strategjia e Bashkimit Evropian është e sanksionuar qartë në Komunikatën e Iniciativës së Komisionit Evropian për Biznesin Social<sup>1</sup> dhe në një sërë dokumentash dhe deklaratash që kanë pasuar këtë iniciativë.<sup>2</sup>

Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale është konsideruar si element i rëndësishëm edhe në kuadër të nismave të Bashkimit Evropian që lidhen me vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE. Kështu, BE-ka miratuar Strategjinë për Evropën Juglindore 2020 (SEJ), si pjesë e Strategjisë Evropa 2020. Kjo strategji, pasqyron vendosmërinë e të gjitha qeverive në Evropën Juglindore për të përqafuar politikën e guximshme për arritjen e niveleve socio-ekonomike të nevojshme për të përmirësuar prosperitetin e të gjithë qytetarëve të saj dhe për të lehtësuar integrimin eventual në Bashkimin Evropian. Problemet sociale dhe papunësia janë probleme me të cilat përballen vendet në përpjekjet e tyre për të përshpejtuar zhvillimin. Strategjia Evropa 2020 synon rritjen e normës së përgjithshme të punësimit nga 39.5% në 44.4% deri në vitin 2020.

---

<sup>1</sup> Komunikimi nga Komisioni në Parlamentin Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve Iniciativa e Biznesit Social, duke krijuar klimë të favorshme për ndërmarrjet sociale, aktorët kyç në ekonominë sociale dhe të inovacionit, 2011

<sup>2</sup> Deklarata e Strasbourgut, 16-17 janar 2014

Formalizimi dhe promovimi i ndërmarrjeve sociale është vlerësuar edhe nga autoritetet e Kosovës jo vetëm si një nevojë për të ndjekur modelet më të mira evropiane, por edhe për të plotësuar e adresuar disa probleme të thella për shoqërinë. Pikërisht me anë të këtij koncept dokumenti synohet të silltet në vëmendjen e autoriteteve vendimarrëse, arsyet që identifikojnë nevojën për hartimin e kuadrit ligjor për formalizimin dhe nxitjen e ndërmarrjeve sociale në Kosovë.

Koncept dokumenti mbështetet nga disa studime dhe nisma paraprake që janë ndërmarrë me qëllim njohjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në Kosovë. Kështu në vitin 2011, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka marrë pjesë në Konferencën “Konventa e I-rë vjetore e Platformës Evropiane, kundër Varfërisë dhe Përrjashtimit Social” të mbajtur në Krakov të Polonisë, 17-18 tetor 2011. Në këtë konferencë, janë prezantuar praktikat dhe aktivitetet e ndërmarrësisë sociale nga vendet pjesmarrëse, ndërsa bazuar në këto eksperiencë është përgaditur një raport nga pjesmarrësit, i cili ka shpjeguar aktivitetet e ndërmarrjeve sociale në Evropë dhe vendet e rajonit, trendet e zhvillimit të tyre dhe politikat e BE-së Ky koncept është mbështetur dhe pranuar nga menaxhmenti i MPMS-së dhe pas kësaj kanë filluar aktivitetet për zhvillimin e konceptit të ndërmarrësisë sociale në Kosovë.

Me iniciativën e MPMS-së janë ndërmarrë aktivitetet për inicimin e hartimit të legjislacioni dhe angazhimin për zhvillimin e ekonomisë sociale dhe ndërmarrësisë sociale si pjesë edhe e obligimeve që dalin nga Strategjia e Evropës Juglindore 2020. Përfaqësuesit e MPMS si pjesë e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal dhe anëtare e grupit të punës për zbatimin e aktivitetëve të SEJ ka marrë pjesë në prezantimin e Studimit Strategjik për Zhvillimin e Ekonomisë Sociale në Kontekstin e Strategjisë së Evropës Juglindore 2020, i cili është prezantuar në qershor të vitit 2014. Studimi është konsideruar si mjaft frymëzues për zhvillimin e ekonomisë sociale edhe në Kosovë.

Së fundmi në koordinim me MPMS-në, Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, (UNDP) në Prishtinë, mundësoi përgatitjen e një studimi/raporti për “Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale në Kosovë- shqyrtimi ligjor” 2014. Ky raport i cilësuar nga MPMS, si shumë përmbajtjesor shpjegon qartë situatën dhe kontekstin ligjor të ekonomisë sociale, përkatësisht të ndërmarrjeve sociale në Evropë, rajon, dhe Kosovë.

Paralel me nismat e marra nga aktorët e ndryshëm ndërkombëtarë edhe MPMS, ka ndërmarrë disa hapa për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në Kosovë. Në tetor 2012, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në takime dhe punëtori të ndryshme ka paraqitur një propozim për angazhimin e ndërmarrjeve sociale në

Kosovë si përgjigje të shqetësimeve për papunësinë, përjashtimin social, procesin e decentralizimit, aftësinë për të dhënë në mënyrë efektive shërbimet sociale. Për këtë qëllim, MPMS, në kuadër të Strategjisë Sektoriale "Punësimi dhe Politikat Sociale" 2014-2020, ka paraparë si aktivitete të saj edhe hartimin e Projektligjit për Ndërmarrjet Sociale në Kosovë. Me këtë, Kosova ka dëshmuar se politikat sociale të vendit tonë, përkatësisht, krijimi i kushteve për iniciimin e ekonomisë sociale, është në përputhje me kërkesat dhe aktivitetet e parashikuara në kuadër të SEJ 2020.

MPMS ka bindjen se me miratimit e një Ligji për ndërmarrjet sociale, do të krijohen kushtet e nevojshme për të inkurajuar iniciativa të zhvillimit të aktiviteteve në dobi të shoqërisë dhe të integritimit në punë të personave të disavantazhuar. Nëpërmjet këtij dokumenti MPMS do t'i propozojë Qeverisë, përgatitjen e një Ligji për Ndërmarrjet Sociale i cili do të bazohet në modelet e vendeve të tjera evropiane të cilat kanë traditë në këtë fushë. Ligji do të rregullojë aspekte që lidhen me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve sociale si dhe do të përcaktojë autoritetet kompetentë përgjegjëse për këto aspekte.

## **Kapitulli -II-**

### ***2. Përshkrimi i çështjes / Problemit kryesor***

Adresimi i problemeve sociale si papunësia, përfshirja sociale dhe ofrimi i shërbimeve të ndryshme në favor të shoqërisë mbetet një sfidë e madhe për vendet në zhvillim. Aktualisht Kosova vuan nga papunësia e lartë. Shkalla e vlerësuar e papunësisë në Kosovë ka qenë rreth 30.9 për qind në vitin 2012. (HDR 2011). Për pasojë nxitja e sipërmarrjes private konsiderohet si domosdoshmëri për rritjen e punësimit dhe mirëqënies sociale në vend. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë një realitet në zhvillim në Kosovë. Ato ushtrojnë aktivitet në fusha të ndryshme, megjithatë ato përballen me disa pengesa të ndryshme të zhvillimit të biznesit. Pengesat janë të ndara në aftësi të barrierave kulturore, infrastrukturore, operacionale, rregullatore dhe të brendshme. Mungesa e aftësive menaxheriale, burokracia, mungesa e besimit, mungesa e kapitalit për bizneset e reja, si dhe të ekonomisë informale janë pengesat kryesore për zhvillimin e NVM-ve. Për pasojë, përfshirja sociale nuk është akoma një çështje që mund të përkrahet dhe zhvillohet brenda kuadrit ekzistues të biznesit në Kosovë.

Në Kosovë, çështjet që lidhen me përfshirjen sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale në dobi të shoqërisë lidhen kryesisht me veprimtarinë e Organizatave jo Qeveritare (OJQ). Në Kosovë ka rreth 4882 OJQ të regjistruara, megjithatë vetëm 500 janë aktive. Disa nga këto OJQ janë përfshirë në aktivitetet ekonomike dhe

sociale në mbështetjen e punësimit dhe të ofrimit të shërbimeve sociale. Për shembull, OJQ-ja "Rrjeti i Grave të Kosovës" është përfshirë në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike për punësimin e grave apo organizatat që mbështesin sektorin social. Një tjetër shembull vjen nga organizata "Handikos" e cila ofron shërbime dhe punësim për njerëzit me aftësi të kufizuara, dhe në veçanti ofron shërbime sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Megjithatë duhet theksuar fakti që këto aktivitete janë sporadike dhe varen kryesisht nga mbështetja e donatorëve të huaj. OJQ-të kryesisht ofrojnë mbështetje në formën e trajnimeve dhe ofrimit të seminarit, ndërsa kanë pak përvojë në aktivitetet ekonomike. Kohët e fundit kjo ka ndryshuar, pasi disa organizata jofitimprurëse janë angazhuar në ofrimin e prodhimit dhe të shërbimeve dhe kanë treguar gatishmëri për t'u angazhuar në aktivitete ekonomike. Veprimtaritë ekonomike apo sociale të OJQ-ve janë akoma larg veprimtarive të mirëfillta të sipërmarrjes që mund të gjeneronin punësim të qëndrueshëm të kategorive në nevojë dhe jo vetëm. Në këtë kuadër studimet e ndryshme kanë theksuar faktin se brenda këtij sektori vihen re organizata të cilat shfaqin tipare apo ushtrojnë aktivitete të ngjashme me ato të ndërmarrjeve sociale, por nga ana tjetër ato identifikojnë nevojën për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e këtyre OJQ-ve për të kuptuar konceptin e sipërmarrjes sociale, veçanërisht nevojën për qëndrueshmërinë afatgjatë të fushëveprimit të tyre.

Mbledhja e të dhënave për sektorin e ekonomisë sociale, është bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Megjithatë nuk ka të dhëna të mbledhura në mënyrë të qartë për ndërmarrjet sociale. Deri më sot, MTI është përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave për bizneset e regjistruara ndërsa MAP është përgjegjës për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave ekzistuese të Organizatave jofitimprurëse të regjistruara në Kosovë.

### *3. Politikat aktuale*

Siç u theksua edhe më sipër, Kosova nuk ka akoma një rregullim specifik për ndërmarrjet sociale dhe as një institucion të dedikuar për këtë çështje. Megjithatë politikat e ndryshme sektoriale që lidhen me integrimin në punë të personave të disavantazhuar apo me ofrimin e të mirave dhe shërbimeve sociale për kategori të ndryshme janë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme. Ashtu sikurse u theksua më sipër, Kosova ka përkrahur sipërmarrjen e lirë dhe në vend janë zhvilluar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që kontribuojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Në Kosovë sikurse në shumë vende të Evropës Juglindore vihet re një rritje e angazhimit të organizatave jo-fitimprurëse në aktivitete ekonomike, të

cilat kanë si qëllim integrimin në punë të personave të disavatazhuar ashtu si edhe ofromin e shërbimeve në dobi të shoqërisë. Në hartimin dhe zbatimin e këtyre politikave rol të rëndësishëm luajnë institucionet e Kosovës si Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe MPMS, si institucionet kryesore si dhe ministrinë e tjera përkatëse, si Ministria e Financave (MF), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe organet e tjera relevante.

Në Kosovë nuk ekziston akoma një strategji kombëtare për zhvillimin e ekonomisë sociale. Megjithatë disa iniciativa të ndërmarra vitet e fundit japin kontribut në këtë drejtim. Kështu, vizioni i zhvillimit ekonomik dhe plani i miratuar i vitit 2011 përfshin masa për zhvillimin e kapitalit njerëzor nëpërmjet trajnimit dhe arsimit profesional si dhe të mirëqenies sociale (të veteranëve, të moshuarve dhe të pastrehëve). Korniza e shpenzimeve afatmesme 2015-2017 thekson prioritet për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke kontribuar kështu në zhvillimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe mirëqenies sociale. Këto objektiva janë reflektuar edhe në strategjitë përkatëse sektoriale. Një nga qëllimet kryesore strategjike të Strategjisë së NVM-ve me (2020) është dhe nxitja e zhvillimit të sektorit të ndërmarrjeve sociale në Kosovë. Strategjia synon përmirësimin e qasjes së NVM-ve në financimin, promovimin dhe zhvillimin e kulturës ndërmarrëse, përmirësimin e dialogut në mes të sektorit privat, sektorit publik dhe shoqërisë civile, forcimin e institucioneve mbështetëse të NVM-ve, si dhe inkurajimin e përfshirjes së grupeve të marginalizuara sociale në aktivitete sipërmarrëse.

Përveç kësaj, MPMS-ja ka përfshirë zhvillimin e ekonominë sociale dhe ndërmarrësisë sociale nganë kuadër të objektivave dhe aktiviteteve në Draft Strategjinë Sektoriale të 2014-2020 dhe Planin e veprimit 2014-2016. Në kuadër të objektivit specifik për zhvillimin e alternativave dhe formave të reja për ofromin e shërbimeve për mbrojtje sociale dhe promovimin e përfshirjes sociale janë parashikuar aktivitete të veçanta duke përfshirë edhe hartimin e një ligji dhe zhvillimin e një modeli për ndërmarrjet sociale.

Mungesa e një strategjie të qartë dhe e një kuadri rregullues për ekonominë sociale ka bërë që Kosova të mos ketë skema të mbështetjes financiare që kontribuojnë në mënyrë të qartë në zhvillimin e ekonomisë sociale. Megjithatë, qeveria kontribuon me një sasi të konsiderueshme të fondeve në krijimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe përfshirjes sociale.

#### *4. Ligjet dhe aktet nënligjore*

Kosova nuk ka një ligj të veçantë për ndërmarrjen sociale. Megjithatë ligje të ndryshme rregullojnë aspekte të veçanta të punësimit e integritimit në punë të personave të disavantazhuar si edhe lejojnë organizatat jofitimprurëse të kryejnë aktivitete ekonomike për qëllime të përmbushjes së objektivave të tyre që shpesh përkojnë me adresimin e nevojave sociale dhe integritimin në punë të personave të disavantazhuar. Themelimi dhe funksionimi i organizatave jofitimprurëse rregullohet nga Ligji nr. 03/L-134 për Lirinë e Asocimit në Organizatat. Institucioni përgjegjës për regjistrimin e OJQ-ve është Ministria e Administratës Publike, Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të.

Ligji nr 03/L-134 për Lirinë e Asocimit dhe Organizimit parashikon se organizata jofitimprurëse mund të zhvillojnë aktivitet ekonomik për brenda qëllimeve që lidhen me veprimtarinë e organizatës. OJQ-të që kryejnë veprimtari ekonomike brenda rregullave të parashikuara në këtë ligj marrin “statusin e përfitimit publik”. Veprimtaria ekonomike e OJQ-ve përfshin ofrimin e të mirave apo shërbimeve përkundrejt kategorive vulnerabël dhe gjithmonë me një kosto më të ulët se vlera e tregut për shërbime apo të mira të ngjashme ose falas. Ato OJQ që veprojnë në fushën e kujdesit shëndetësor ose arsimit janë të detyruara që t’i paraqesin hollësitë e tipareve të grupeve të synuara dhe përfituesve që u shërbejnë, si dhe shërbimet e ofruara.

OJQ-të mund të angazhohen në aktivitete ekonomike, me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të tyre jofitimprurëse, dhe me kusht që të ardhurat të përdoren vetëm për të realizuar misionin e përcaktuar në statutin e OJQ-së. Përveç kësaj, OJQ-ve u lejohet fillimi i bizneseve, ndonëse kjo formë ligjore përmban kufizime gjatë rritjes së bizneseve. Kështu, mjedisi ligjor mund të konsiderohet se mundëson organizatat jofitimprurëse apo bizneset, në qoftë se nuk ka pengesa madhore që të angazhohen në aktivitete ndërmarrëse me mision social.

Iniciativat private dhe aktiviteti ekonomik në Kosovë realizohet nëpërmjet shoqërive tregtare, themelimi apo format e organizimit dhe aktivitetet e tyre rregullohen nga Ligji për shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare). Ligji identifikon llojet vijuese të shoqërive: shoqëri kolektive, shoqëri komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara ose shoqëri aksionare.

Për të nxitur dhe mbështetur aktivitete të ndryshme sociale në interes të shoqërisë, Kosova ka miratuar edhe një ligj për shërbimet sociale Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17. Ligji përcakton detyrat e komunave



në ofrimin e shërbimeve sociale përmes Drejtorive apo Qendrave për Punë Sociale (QPS). Drejtorive u lejohet të sigurojnë ose lehtësojnë, përmes QPS-ve apo organizatave joqeveritare, ofrimin e shërbimeve sociale si në vijim: ndihmë në familje, kujdesin e drejtpërdrejtë personal në shtëpi, qendra ku individët në nevojë mund të vijnë në baza ditore, shërbime të këshillimit për njerëzit me varësi ose probleme të tjera psiko-sociale, përkujdesje rezidenciale për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta, si dhe çdo shërbim tjetër i përshtatshëm që ka të bëjë me shërbimet sociale dhe familjare.

Aftësimi dhe integrimi në punë i personave me aftësi të kufizuara rregullohet nga Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ligji siguron mbështetje ligjore dhe institucionale për aftësitë, rehabilitimin, nxitje në aftësimin profesional për punësimin e duhur të personave me aftësi të kufizuara në bazë të parimeve dhe trajtimit të barabartë, duke përfshirë orientimin e ndjeshëm gjinor. Gjithashtu, ai siguron një përkufizim të personave me aftësi të kufizuara. Sipas ligjit, personat me aftësi të kufizuara janë persona që kanë dëmtime akute fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët. Ky ligj siguron dhe kuadrin rregullues për themelimin e qendrave për punësim profesional dhe rehabilitim. Këto qendra mbikqyren nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ligji për personat me aftësi të kufizuara inkurajon punëdhënësit që t'i punësojnë ata duke ofruar ulje tatimore dhe të taksave doganore. E drejta në lehtësira të detyrimeve doganore dhe tatimore realizohet në përputhje me ligjet tatimore dhe doganore në fuqi. Punëdhënësi, duke punësuar një person të papunë me aftësi të kufizuara në bazë të dispozitave të ligjit ka të drejtë të përfitojë subvencione materiale.

Qendrat për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim në Kosovë krijojnë të ardhura nga burime të ndryshme (p.sh. donacione). Për të përfituar nga përjashtimet tatimore, Qendra mban kontabilitet të veçantë. Të ardhurat e realizuara përdoren për zgjerimin e kapaciteteve të Qendrës për trajnimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, krijimin e vendeve të reja të punës, furnizimin e Qendrës me teknologji të reja, si dhe përmirësimin e standardeve të njerëzve me aftësi të kufizuara (shih nenin 21 të ligjit).

Ligji për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 përcakton fuqinë e plotë të autoriteteve lokale për sa i përket interesave lokale. Autoritetet lokale në Kosovë, sikurse në çdo vend tjetër evropian, janë përgjegjëse për çështje të interesave sociale dhe të punësimin. Ligji për vetëqeverisje liston fushat në të cilat autoritetet lokale kanë kompetenca ekskluzive dhe këto ushtrohen në përputhje me standardet e përcaktuara në ligjin në fuqi për fushat si zhvillimi lokal ekonomik, liçencimi i shërbimeve lokale dhe objekteve që kanë të bëjnë me kulturën,

mbrojtjen e mjedisit e kështu me radhë. Autoritetet lokale gjithashtu janë të përfshirë drejtpërdrejt në çështjet e shëndetit publik, edukimin dhe ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale, siç është kujdesi për fëmijët e cenusëshëm dhe kategoritë e tjera të mbrojtura. Në kuadër të ofrimit të këtyre shërbimeve ose ushtrimit të kompetencave të tyre, komunat e Kosovës gjithashtu kërkohen të nxisin zhvillimin e organizatave në qoftë se ofrojnë shërbime që janë nën përgjegjësinë e përgjithshme të komunës. Komuna mund të nënshkruajë marrëveshje me këto organizata me qëllim që të lejojë që ata të ofrojnë shërbime nën përgjegjësinë e pushtetit lokal.

Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Ligji nr. 03/L 146, i ndryshuar, përcakton përjashtimin tatimor të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve të lidhura ngushtë me punën e mirëqenies dhe sigurisë sociale, duke përfshirë mallrat dhe shërbimet e furnizuara për shtëpitë e njerëzve të moshuar. Ofruesit e shërbimeve duhet të jenë ose subjekte kompetente publike në Kosovë ose subjekte të tjera të njohura nga Autoriteti kompetent i Kosovës që janë të përkushtuara në mirëqenie sociale dhe që kanë çmime të krahasueshme. Furnizimi i mallrave dhe shërbimeve të lidhura ngushtë me mbrojtjen e fëmijëve është gjithashtu e pranuar për lirim të TVSH-së. Përsëri, këto mallra dhe shërbime duhet të ofrohen nga subjektet publike kompetente të Kosovës ose të organizatat e pranuar nga Autoriteti kompetent i Kosovës që janë të përkushtuara në mirëqenie sociale dhe se kanë çmime të krahasueshme. Përveç kësaj, ligji parashikon edhe reduktimin e normave standarde të TVSH-së. Norma e rregullt e TVSH-së së zbatueshme në Kosovë është gjashtëmbëdhjetë për qind (16%). Megjithatë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, me vendim të Qeverisë së Kosovës pas miratimit të Kuvendit, mund të nxjerrë një akt nënligjor për aplikimin e normës së reduktuar prej jo më pak se pesë për qind (5%) për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve.

Ligji për Prokurimin Publik nr. 04-L-042 (2011) parashikon përjashtim nga rregullat e prokurimit publik në rrethana të veçanta. Asnjë nga rastet e listuara nuk përfshin situatat ku shërbimet e interesit të përgjithshëm social ofrohen nga entitetet jopublike.

##### *5. Programet aktuale*

Organizata të ndryshme ndërkombëtare në kuadër të programeve të ndihmës dhe mbështetjes për autoritetet në Kosovë kanë ndihmuar gjithashtu edhe në promovimin e aspekteve të ndryshme që lidhen me sipërmarrjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sociale. Kështu, Zyra e BE-së financon projektin KOSVET VI për zhvillimin e Profesional dhe In-Company, skemat e trajnimit dhe zhvillimit të Skemës për ndërmarrësi. GIZ gjithashtu ofron mbështetje të rëndësishme në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe rural me disa projekte siç janë: Ekonomi dhe nxitja e punësimit (2011-2018), Zhvillim ekonomik rural (2010-2018), Promovimi i

qendrave të aftësive, si pjesë e reformës së formimit profesional (2003 -2017) dhe zhvillimin social.

Gjithashtu UNDP përmes programit të zhvillimit gjithpërfshirës është duke zbatuar një numër të projekteve që kontribuojnë në punësim dhe përfshirjen sociale të tilla si: Zona e Programit për Zhvillim në Mitrovicë dhe Zveçanit, Ndërmarrësia dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal; Ndihma për Tregtinë (2012 - 2014); Programet aktive të tregut të punës për të rinj (2005 - 2014); Ndërtimi i një të ardhme më të mirë për qytetarët e Fushë Kosovës dhe Obiliqit / C (2012-2015), projekt i cili ka krijuar dy ndërmarrje sociale si dhe projektet në nivel lokal për Gjenerim të Punësimit dhe të Zhvillimit të Integruar të Territorit (2014-2017), i cili mbështeti krijimin e ndërmarrjeve sociale në Dragash dhe është duke punuar në krijimin e një ndërmarrjeje të tillë dhe në komunën e Shtërpçës. Projekti do të kontribuojë për punësimin e drejtpërdrejtë të 450 përfituesve të rrezikuar nga përjashtimi ekonomik dhe social si edhe në mënyrë të tërthortë për 1,400-1,700 të po kësaj kategorie, në mënyrë të veçantë për fermerët dhe njësitë e tjera të vogla dhe mikro-prodhimit që janë të mbështetura kryesisht me sigurimin aktual të shërbimeve në mbështetje të biznesit dhe qasje në treg. Nga fusha e bujqësisë, rreth 1.5% e fermerëve janë të organizuar në formë të shoqatës, ndërsa vetëm 0.8% në formë të kooperativës. Megjithatë, aktivitetet e tyre janë të kufizuara dhe janë mbështetur kryesisht nga fondet e donatorëve, të tilla si UNDP "Mbështetja e Organizatave Bujqësore" Projektit - SAO, i zbatuar në vitin 2006.

Komisioni Evropian në bashkëpunim me MPMS, ka përfunduar fazën e parë të një projekti të financuar nga IPA 5 milionë "Kosova e Bukur" 2011-2013, i cili projekt është zbatuar nga IOM, që synon në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe reduktimin e varfërisë në komunat e zgjedhura duke rritur mundësitë ekonomike për popullsinë e Kosovës, veçanërisht grupet e marginalizuara. Programi u zbatua me sukses duke siguruar punësim për 1,905 persona, duke përfshirë ato nga grupet në nevojë. Faza e dytë e projektit 2014-2016 është duke vazhduar me shtesë 5.0 milionë akorduar nga BE-ja, e cila vazhdon të zbatohet nga IOM në koordinim me MPMS-në. Gjithashtu KE ka është duke mbështetur MPMS-në për pilotimi e dy Inkubatorëve Social (Mitrovicë dhe Graçanicë), në kuadër të cileve ndërmarrjes sociale do të jenë përfituesit kryesor.

Përveç projekteve të përmendura më lartë, ka iniciativave të tjera duke përfshirë inkubatorët, qëllimi i të cilëve është mbështetja në krijimin e vendeve të punës me qasje inovative dhe trajnimin për ndërmarrësi të tilla si Innovation Lab Kosovë e financuar nga UNICEF, Innovation Centre Kosovë të financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, e të tjerë.

Për sa i përket bashkëpunimit rajonal dhe ndërkuftar, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë është një nga donatorët kryesorë. Mbështetja është dhënë

përmes komponentit të IPA 2 financuar 1.200.000 euro në 2010, 1.800.000 euro në 2011, 2.929.148 në vitin 2012 dhe 2.987.731 euro në vitin 2013 përmes Agjencive të Zhvillimit Rajonal, të cilat ishin përgjegjës për të mbështetur zbatimin e disa projekteve të bashkëpunimit ndërkuftar me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe aktivitetet e përfshirjes sociale. Projektet e bashkëpunimit përfshinin disa vende fqinje - Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Malit të Zi.

## *6. Përvoja në shtetet e tjera*

Në dy dekadat e fundit ndërmarrjet sociale kanë patur një zhvillim të madh në vendet e ndryshme evropiane. Ato kanë filluar të jenë një realitet i ri edhe për vendet e Evropës Juglindore duke përfshirë dhe vendet e rajonit dhe Shqipërinë. Kjo e fundit është duke hartuar dhe diskutuar kuadrin ligjor për ndërmarrjet sociale. Në përgjithësi vendet që kanë pranuar ndërmarrjet sociale si një instrument për arritjen e qëllimeve sociale, kanë hartuar dhe miratuar ligje të veçanta për themelimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Objektivi social i ndjekur nga ndërmarrjet sociale ndan ligjet e ndërmarrjeve sociale të vendeve evropiane në dy kategori kryesore: (1) ligjet që rregullojnë integrimin e punës së njerëzve në pozitë të pafavorshme përmes veprimtarisë ndërmarrëse (ËISE - ndërmarrjet sociale me integrim në punës) organizimi ndërmarrës i së cilave është tipari kryesor që e dallon këtë lloj të biznesit nga llojet e tjera të nismave të integritit të punës, dhe (2) ligjet që mbulojnë organizatat të cilat punojnë në fusha të kufizuara të veprimtarive, si bashkëpunimi për zhvillim, arsimim, advokim, mbrojtje e mjedisit, e të tjera.

Vendet e BE-së që e rregullojnë kornizën e tyre vetëm në kuadër të sistemit ËISE janë: Finlanda, Polonia, Greqia dhe Lituania. Sipas legjislacionit të tyre, ndërmarrjet sociale duhet të punësojnë ose të themelohen nga persona me aftësi të kufizuara, persona në pozitë të pafavorshme dhe persona me papunësi afatgjatë. Në përgjithësi, ekziston një përqindje e kufizuar e përfaqësuesve nga kategoritë e mësipërme që variojnë nga 30-40% të numrit të përgjithshëm të punëtorëve. Shumë ligje i referohen Rregullores Evropiane nr. 2204/2002 (neni 2), për përkufizimin e personave në pozitë të pafavorshme dhe atyre me aftësi të kufizuara. Në ligjin e Spanjës dhe të Italisë, integrimi në punë konsiderohet si aktivitet social në vetvete dhe, për këtë arsye, këto ligje japin lirinë e zgjedhjes për sa i përket sektorit në të cilin mund të nisët një biznes.

Për sa i përket kategorisë së dytë, ndërmarrjet sociale që kryejnë një lloj të caktuar të veprimtarisë mund të dallohen në ligjet që parashikojnë një numër të kufizuar të veprimtarive që do të kryhet, ndërkohë që ligje të tjera nuk

parashikojnë asnjë kufizim në kuptim të aktiviteteve dhe qëllimi fundor social konsiderohet të jetë përpjekje për të sjellë ndryshime sociale për komunitetin.

Studime të ndryshme mbështesin idenë që ndërmarrjet sociale kanë tipare edhe të bizneseve tradicionale edhe forma tradicionale të organizatës jofitimprurëse. Deri tani, vendet evropiane kanë zgjedhur zgjidhje të ndryshme ligjore për themelimin e ndërmarrjeve sociale. Në disa vende, kooperativat sociale janë përdorur si i vetmi shembull i ndërmarrjeve sociale (Francë, Greqi, Poloni, Portugali dhe Spanjë), ndërsa në disa vende të tjera evropiane (Belgjikë, Finlandë, Itali, Letoni, Lituani, dhe Mbretëri e Bashkuar) ndërmarrjet sociale nuk janë të kufizuara në kooperativa sociale, por gjithashtu mund të marrin forma të tjera ligjore. Duke pasur këtë parasysh, mund t'i dallojmë format e mëposhtme ligjore që ndërmarrjet sociale shpeshherë kanë në vendet evropiane:

1. **Modeli i kooperativave me ndërmarrje sociale që veprojnë si kooperativë me qëllime sociale;**
2. **Modeli i kompanisë i dalë nga modeli jofitimprurës dhe i kufizuar nga një objektiv social;**
3. **Modeli i formës së hapur i përkufizuar me ligj bazuar në qëllimin e tyre social pa konsideruar formën ligjore;**

Pavarësisht formës ligjore të ndjekur, është shumë e rëndësishme të kuptohet qartë se çfarë janë ndërmarrjet sociale. Ndërmarrja sociale duhet kuptuar si një entitet i ri i cili funksionon me rregullat e ekonomisë së tregut por për një mënyrë të veçantë menaxhimi, që nuk nisët nga qëllimet e fitimit por nga adresimi i nevojave sociale. Praktika e deritanishme në Kosovë dhe në vende të tjera na tregon se entitete të tjera juridike kontribuojnë në këtë drejtim por asnjëra prej tyre si nga forma e qeverisjes ashtu edhe nga qëllimet nuk mund të zëvendësojë këtë simbiozë midis privates dhe statusit të përfituesit publik. Karakteristikat e ndërmarrjeve sociale mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. mungesa e qëllimit të fitimit; një ndërmarrje sociale duhet të krijohet si e tillë që nga fillimi, ajo kryen aktivitet ekonomik por të ardhurat dhe fitimet e saj nuk shpërndahen në formën e fitimit midis themeluesve apo punonjësve, por ri -investohen për qëllime sociale (p.sh rritje e numrit të punonjësve në rastet kur ata vijnë nga kategoritë e disavatazuara, trajnimi i punonjësve, apo zgjerimi i aktiviteteve të tjera për qëllime sociale)
2. krijohet në mënyrë të pavarur nga themeluesit

3. krijohet me qëllim që të kontribuojë në aktivitete sociale, si duke punësuar persona të disavantazhuar ashtu dhe duke shërbyer për interesin e përgjithshëm publik
4. karakterizohet nga një prezencë e lartë e punonjësve që punojnë në mënyrë vullnetare
5. vepron me të gjitha parimet e ekonomisë së tregut
6. vepron mbi një vendimmarrje demokratike dhe krijon kushtet e nevojshme që themeluesit dhe punonjësit të marrin pjesë në vendimmarrjet e rëndësishme të ndërmarrjes sociale pavarësisht kontributit të tyre në themelimin e ndërmarrjes
7. ndalon shpërndarjen e të ardhurave dhe fitimit dhe garanton një nivel të lartë të transparencës në menaxhimin e financave
8. ndërmerr në mënyrë të vazhdueshme aktivitete në interes të anëtarëve të saj dhe në interes të komunitetit, i cili gjithashtu ftohet të marrë pjesë në disa nga vendimmarrjet e ndërmarrjes dhe konkretisht në vendimet që kanë të bëjnë me cilësinë apo llojin e aktiviteteve nga të cilat vetë komuniteti përfiton

Në Kosovë, ashtu sikurse në të gjitha vendet evropiane, ligjërisht dhe strukturalisht ka një ndarje të pastër midis aktiviteteve ekonomike të ndërmarrja nga iniciativat private të cilat janë të përfshira në aktivitete fitimprurëse dhe që nisen nga qëllime fitimi; dhe organizimeve dhe aktiviteteve jofitimprurëse të cilat zhvillohen nga organizatat jofitimprurëse. Të dy format e sipërpërmendura gjenerojnë punësim dhe i vinë në ndihmë shoqërisë, por asnjëra nuk e kam qëllim final. Ndërmarrjet Sociale duhen dalluar pikërisht nga integrimi në punë i kategorive që kanë vështirësi në tregun e punës, që nuk janë domosdoshmërisht personat me aftësi të kufizuar, dhe ndihma që i jep komuniteti dhe shoqërisë për ato aktivitete që janë të nevojshme për të. Ato duhet të krijojnë kushte për pjesëmarrjen e përfituesve të shërbimeve dhe të mirave të ofruara prej saj dhe vullnetarëve në drejtimin e punës së ndërmarrjes, cka përbën një tjetër dallim midis këtij entiteti dhe formave klasike të organizimit që ekzistojnë sot në Kosovë dhe në vendet e tjera evropiane.

### **Kapitulli III.**

#### ***7. Synimet dhe Objektivat :***

Synimi kryesor i këtij Koncept Dokumenti është krijimi i infrastrukturës ligjore për zhvillimin e ndërmarrjes sociale në Kosovë. Gjithashtu, ligji do të përcaktojë rolin e aktorëve të ndryshëm publik lidhur me themelimin, mbështetjet dhe monitorimin e funksionimit të ndërmarrjes sociale në Kosovë.

Ligji do të parashikojë të gjithë instrumentat e nevojshëm për promovimin dhe zhvillimin e ndërmarrsisë sociale. Nëpërmjet nxitjes së themelimit të

ndërmarrjeve sociale, ne do të synojmë adresimin e çështjeve të ndryshme sociale që lidhen me uljen e papunësisë dhe veçanërisht përfshirjen në punë të personave të disavantazhuar, si edhe ofrimin e të mirave dhe shërbimeve të ndryshme sociale në interes të shoqërisë.

### *Objektivi*

Objektivi kryesor i këtij Ligji, është që të kontribuojë krahas formave ligjore ekzistuese në nxitjen dhe zhvillimin e atyre formave dhe aktiviteteve që adresojnë çështje sociale në Kosovë, përfshirë punësimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe të mirave në interes të shoqërisë. Gjithashtu, pjesë e objektivave të ligjit është gjithashtu nxitja e ideve inovatore dhe shpirtit të sipërmarrjes në Kosovë, si një kontribut për zhvillimin e ekonomisë së tregut në Kosovë dhe qasjen e saj konform trendeve më të fundit evropiane dhe rajonale.

## **Kapitulli IV: Opsionet**

### *8. Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)*

Kosova ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe politikash për adresimin e çështjeve sociale sidomos të atyre që lidhen me papunësinë, integrimin në punë të grupeve të disavantazuara dhe me paaftësi të ndryshme, si edhe për ofrimin e shërbimeve të ndryshme sociale në shërbim të shoqërisë dhe individëve. Megjithatë, studimet e ndryshme tregojnë se instrumentat e përdorur deri më tani nuk kanë qenë të mjaftueshëm për të ulur efektet negative të fenomeneve të ndryshme që lidhen me papunësinë dhe mirëqenien sociale të shoqërisë. Nga njëra anë, biznesi privat nuk ka krijuar mjaftueshëm vende punë dhe njëkohësisht nuk ka mundur të angazhojë persona të disavantazhuar dhe me paaftësi; ndërkohë që shoqëria civile shpesh e angazhuar në aktivitete ekonomike për qëllime sociale është e varur kryesisht në donacionet dhe mbështetjen e organizatave të ndryshme të cilat ofrojnë një mbështetje që orientohet kryesisht në aktivitetin jofitimprurës të organizatës dhe më pak në aktivitetin ekonomik të saj. Deri më tani, përgjegjësia e ofrimit të shërbimeve sociale i takon shtetit i cili në raste sporadike kërkon ndihmën e organizatave jofitimprurëse që të ndihmojnë këtë të fundit në ofrimin e këtyre shërbimeve. Në çdo rast, mungon një qasje sistematike e organizuar nëpërmjet partneritetit privat publik për adresimin e çështjeve sociale; dhe njëkohësisht të dhënat lidhur me punësimin tregojnë që ka akoma shumë punë për të bërë dhe ekzistojnë gjithashtu hapësira të mjaftueshme për të akomoduar forma të reja të nxitjes, që në rastin konkret do të materializohen nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes sociale.

### *9. Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese*

Në ndryshim nga Status Quo, opsioni i dytë, pra krijimi i kushteve ligjore dhe institucionale për themelimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale do të

hapë një perspektivë të re për Kosovën. Format ekzistuese juridike si ndërmarrjet e vogla apo të mesme, organizatat jofitimprurëse apo kooperativat do të vazhdojnë të luajnë rolin e tyre në adresimin e çështjeve me karakter social duke përfshirë dhe punësimin; por përsëri kufizimet që vijnë si rezultat i qëllimeve që ata duhet të ndjekin dhe organizimi i tyre nuk do të lejojë që ata të kontribuojnë maksimalisht në adresimin e këtyre problemeve. Duke qenë se biznesi nisët nga qëllime fitimi, sado që ai të ketë lehtësira për punësimin e personave të disavantazuar, përsëri nuk do të jetë i prirur në punësimin e kësaj kategorie. Nga ana tjetër, një organizatë jofitimprurëse nuk mund të përdorë gjithmonë donacionet për veprimtaritë ekonomike dhe në çdo rast ajo është e kufizuar si në llojin e aktivitetit ekonomik që mund të lejohet të kryejë, ashtu edhe në të qenurit konkurrues në treg. Nxitja e ideve inovatore do të mbetet pushtet vetëm i atyre që kanë të ardhura të mjaftueshme për të zhvilluar një ide pavarësisht nivelit të tyre të kualifikimit. Instrumenti i ri i ofruar nga ndërmarrja sociale ofron një simbiozë që bashkon aspekte të ndryshme të të gjitha formave ekzistuese, duke na siguruar kështu një formë e cila ka objektivin social qëllim primar mbështetur në iniciativën e lirë, punësimin dhe zhvillimin e ideve inovatore duke qenë konkurrues në treg si në cilësi ashtu edhe në çmim krahasuar me aktorë të tjerë. Kjo formë e re mund të thihet një numër të caktuar si nga OJF-të ekzistuese apo bizneset e vogla apo të mesme si edhe kooperativat që të dalin gradualisht nga organizimi klasik, dhe shndërrohen në ndërmarrje sociale pasi të kenë përshtatur aktet e tyre të themelimit me parimet bazë të funksionimit të ndërmarrjeve sociale. Në të njejtën kohë, do të ndërmeren masa dhe studime rajonale për të identifikuar zonat dhe aktivitetet në të cilat mund të përqëndrohet vëmendja për të nxitur krijimin e ndërmarrjeve të reja sociale.

#### *10. Opsioni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit/ Opsion i rekomanduar*

Duke marrë në konsideratë çështjet e lartpërmendura, opsioni i rekomanduar i MPMS-së, është hartimi dhe miratimi i Ligjit për Ndërmarrjet Sociale në Kosovë. Me miratimin e këtij ligji, Kosova do të rriste mjetet dhe mundësitë për individët dhe autoritetet për të adresuar dhe ulur efektet negative të problemeve sociale në Kosovë. Projektligji i ri do të ofrojë një koncept të qartë të asaj që do të quhet sipërmarrje sociale, si dhe do të rregullojë krijimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale. Qëllimi social i ndërmarrjeve sociale do të përfshijë të dyja format, si integrimin në punë të personave të disavantazuar ashtu edhe kryerjen e aktiviteteve sociale. Këto forma, do të jenë të përcaktuara në ligj si Tipi A dhe Tipi B. Në Tipin A, do të kategorizoheshin ndërmarrjet sociale të cilat ofrojnë shërbime sociale për grupet e disavantazuara dhe kryesisht do të përcaktoheshin edhe cilat lloje të shërbimeve sociale ofrohen etj. Ndërsa në formën tjetër do të jetë Tipi B, ku do të kategorizoheshin ndërmarrjet sociale të cilat punësojnë së paku 30% të grupeve të disavantazuara. Ligji, do të lejonte



mundësin edhe bashkimin e këtyre dy formave të cilat ofrojnë edhe shërbime sociale por edhe punësim për grupet e disavantazhuara. Përkufizimi i personave të disavantazhuar do të bëhet në përputhje me përkufizimin e ofruar nga Rregullorja e BE-së, ndërkohë që lista e aktiviteteve me objektiva sociale do të merret nga praktikrat e vendeve evropiane, si për shembull nga ligji italian apo ai sloven i ndërmarrjeve sociale. Projektligji do të sanksionojë se ndërmarrjet sociale do të jenë persona juridikë jofitimprurës të cilët mund të krijohen në një nga format juridike të parashikuara nga ligjet e Kosovës si shoqëri, kooperativa apo organizata jofitimprurëse, që në aktet e tyre të themelimit do të bëhet i qartë qëllimi social i themelimit të ndërmarrjes sociale. Projektligji do të ndajë qartë dy momente që lidhen me themelimin e ndërmarrjeve sociale. Së pari, regjistrimi i tyre do të bëhet në një nga autoritetet përgjegjëse sipas formës juridike që kanë zgjedhur themeluesit e ndërmarrjes; ndërkohë që statusi i ndërmarrjes sociale do të jepet nga MPMS dhe po aty do të mbahet dhe regjistri i tyre. Projektligji do të përcaktojë se cilat parimet bazë të ndërmarrjes sociale duhet të përmbahen edhe në dokumentat themeluese. Projektligji do të parashikojë të gjitha rregullat e transparencës dhe të kontrollit në mënyrë që ndërmarrja sociale të mos devijojë nga qëllimi social dhe gjithashtu do të parashikojë se cilat do të jenë instrumentat ndihmues për të zhvilluar dhe promovuar ndërmarrjet sociale. Ndihma do të konsistojë në përgatitjen e planeve dhe studimeve për zonat dhe llojin e aktiviteteve që do të ushtrojnë ndërmarrjet sociale, por edhe në ofrimin e fondeve si nga buxheti i shtetit dhe nga fonde të ndryshme të Bashkimit Evropian. Gjithashtu për llojin e ndërmarrjes që krijohet me qëllimin që të punësojë persona nga kategoritë e disavantazhuara mund të parashikohen edhe subvencione për sigurimet dhe pagat e tyre. Praktikrat e vendeve të tjera parashikojnë edhe lehtësira të tjera fiskale si përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat ose ulje të TVSH për produktet që përdor ndërmarrja, megjithatë kjo është opsionale, pasi përse kohë ndërmarrjet sociale duhet të jenë konkurruese në treg ato duhet ti nënshtrohen të gjitha kushteve të tregut dhe këtë pikë mund të trajtohet njësoj si cdo entitet tjetër. Këto masa do të ndërmerren si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar.

## **Kapitulli V dhe Kapitulli VI: : Përmbledhja dhe Analiza e opsioneve**

### ***11. Përfitimet***

Në ditët e sotme integrimi njerëzor dhe mirëqenia sociale mbetet një sfidë e madhe. Shtetet evropiane në mënyrë të vazhdueshme promovojnë politikrat dhe instrumentat e nevojshëm në shërbim të këtyre qëllimeve. Pikërisht promovimi i ekonomisë sociale dhe ndërmarrjeve sociale është konsideruar si një hap i nevojshëm për integrimin njerëzor dhe rritjen e cilësisë së jetës të individëve. Ndërmarrja sociale në formën e një simbioze midis inicativës së lirë dhe mungesës së qëllimeve të fitimit ka arritur të sigurojë punësimin e kategorive që

kanë vështirësi për të hyrë në tregun e punës dhe ofrimin e aktiviteteve sociale në interes të përgjithshëm kolektiv. Krijimi i kuadrit ligjor dhe institucional për ndërmarrjet sociale, së pari do të mundësojë që ky entitet i ri të zhvillohet krahas entiteteve ekzistuese siç janë bizneset, OJQ-të apo kooperativat. Ai do të krijojë kushtet për transformimin gradual të atyre entiteteve, që veprojnë apo kanë dëshirën të veprojnë si ndërmarrje sociale duke u mundësuar atyre pasjen e një statusi të qartë, i cili do tu jepte forma të tjera mbështetjeve për daljen në treg. Krijimi i këtyre entiteteve të reja do të mundësonte hapjen e vendeve të reja të punës dhe njëkohësisht do të krijonte partnerë të rinj për autoritetet lokale për zbatimin e një sërë nismash që lidhen me ofrimin e shërbimeve dhe të mirave në interes të shoqërisë.

### *12. Pasojat negative*

Gjenerimi i vendeve të punës sidomos për kategori të caktuara që shpesh janë kosto për shtetin, është i vështirë të sigurohet tërësisht nga biznesi privat që nisat nga qëllime fitimi. Po kështu, organizatat jofitimprurëse do të mbeten të kufizuara në rolin që ato mund të luajnë si promotore të veprimtarisë sociale dhe nxitjes së ideve të reja, pasi në thelb ato nuk mbështeten në veprimtari ekonomike dhe shpesh krijohen për të ndihmuar shoqërisë me mjete dhe forma të tjera (siç është ndërgjegjësimi, avokatia e të tjerë). Në këto kushte do të mbetet përsëri barrë për shtetin dhe autoritetet e Kosovës jo vetëm çështja e integritetit në punë të kategorive të personave të disavantazuar, por edhe ofrimi i atyre shërbimeve që do të ndikonin në rritjen e cilësisë së jetës së individit dhe shoqërisë. Për pasojë, mos krijimi i kushteve të nevojshme për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale do të vazhdonte të ruante atë situatë ku sektori privat do të gjeneronte punësim deri në një masë të caktuar dhe kryesisht për persona të përshtatshëm për të, dhe OJQ-të do të mbeteshin e vetmja shpresë për integrim social por kjo e fundit do të varej kryesisht nga fondet e huaja dhe nga kufizimi që i sjell qëllimi i themelimit të saj. Shteti do të mbetet i zbuluar në këtë drejtim dhe sektorët e ndryshëm do të dilnin jashtë formave klasike të funksionimit për qëllim të ardhjes në ndihmë të promovimit dhe integritetit human.

### *13. Efekti shpërndarës*

Krijimi i ndërmarrjeve sociale është një çështje kombëtare por ndikimi i saj do të jetë shumë i madh në nivel lokal. Ndërmarrjet sociale mund të zhvillohen në të gjitha komunat e Kosovës dhe veprimtaria e tyre mund të shtrihet në shumë sektorë të edukimit, mbrojtjes së mjedisit, ndihmës sociale dhe promovimit të vlerave njerëzore në përgjithësi. Krijimi i kuadrit ligjor, që nuk kufizon as formën juridike dhe as llojin e ndërmarrjeve sociale, do të ndihmojë në transformimin e bizneseve apo OJQ-ve ekzistuese në ndërmarrjet sociale duke legjitimuar disa prej tyre të krijuar nga mbështetja e donatorëve të ndryshëm, dhe do të krijojë

kushtet për krijimin e ndërmarrjeve të reja në të gjitha këto komuna ose në komuna të reja.

#### **14. Kostoja**

Qeveria mund të planifikoj dhe alokoi mjete buxhetore për mbështetje të Ndermarrjeve Sociale e cila mbështetje mund të realizohet përmes Skemes së Grantëve për punësimin e grupeve të cenuara dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

#### **Kapitulli VII: 15. Konsultimi**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si organ propozues i këtij Koncept Dokumenti, konform Rregullores së Punës së Qeverisë, ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike.

Konsultimet fillestare janë me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Dhomën e Biznesit, dhe Agjensinë e Regjstrimit të Biznesit.

Ndërsa Konsultimet paraprake dhe publike janë zhvilluar konform nenit 7 dhe 32 të RRPQ nr. 09/2011.

#### **Kapitulli VIII: 16. Krahasimi i opsioneve**

Duke marrë në konsideratë opsionin e dytë dhe opsionin e rekomanduar, me krijimin e ndërmarrjeve sociale do të rritet numri i të punësuarve nga kategoritë e personave të diavantazuar dhe njëkohësisht do të rritet dhe cilësia e shërbimeve me interes të përgjithshëm publik. Opsioni i dytë do të fokusohet më shumë në nxitjen e formave të ndryshme të sipërmarrjes dhe promovimit të vlerave njerëzore. Hartimi i një ligji që nuk kufizon formën juridike dhe lë të hapur modelin e ndërmarrjes sociale do të ndihmojë që në Kosovë që të realizohen njëkohësisht të dy aspektet sociale si punësimi ashtu edhe ofrimi i shërbimeve dhe të mirave për komunitetin. Projektligji do të mundësojë krijimin e iniciativave të reja që do të gjenerojnë ide dhe mundësojnë zhvillimin ekonomik lokal në ato komuna ku ndërmarrësia sociale do të jetë prezente dhe e aftë për tu zhvilluar. Ligji do të bëjë të qartë kushtet që duhet të plotësojnë ndërmarrjet sociale parashikimin e këtyre kushteve në aktet themeluese dhe kontrollin e vazhdueshëm. Detyrimi për të punësuar persona të disavantazuar në mënyrë progresive (pra një numër në rritje për çdo vit) do të ndihmojë që ndërmarrja ta ruaj këtë objektiv. Nga ana tjetër ligji do të parashikojë edhe kushte të tjera të forta për ekzistencën në treg të ndërmarrjeve sociale dhe suksesin e saj vit pas viti. Ligji do të mundësojë që disa nga entitetet (OJQ apo kompanitë) ekzistuese të shndërrohen ndërmarrje sociale pasi të kenë përmbushur kushtet e parashikuara në projektligj. Në një plan të parë duket se kostot e shtetit për krijimin e ndërmarrjeve sociale fokusohen tek angazhimi dhe krijimi i

kapaciteteve administrative që do të trajnohen për regjistrimin dhe kontrollin e veprimtarisë së ndërmarrjeve sociale. Ndërkohë që për format e mbështetjes qeveria mund të konsiderojë fonde nga subvencionet si për punonjësit ashtu edhe për bizneset në mënyrë që një pjesë të tyre ti përdorë potencialisht për mbështetjen e parë për ndërmarrjen sociale.

#### **Kapitulli XIX: 17.Rekomandimi**

Integrimi njerëzor dhe rritja e cilësisë së jetës dhe shërbimeve në dobi të shoqërisë do të mundësohet nga krijimi i ndërmarrjes sociale. Nxitja e punësimit dhe përfshirja në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi, do të mundësohet nëse Qeveria e Kosovës të miratojë këtë Koncept Dokument, në mënyrë që kjo kategori e shoqërisë të integrohet sa më mirë në shoqëri. Rekomandimi ynë është që Qeveria ta miratojë opsionin e rekomanduar në pikën 10 të këtij dokumenti.

Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti nga Qeverria e Kosoves, MPMS-ja, do të propozoj që kjo nismë ligjore, të përfshihet në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2015.

#### **Kapitulli X: 18. Komunikimi**

Mënyra e komunikimit me aktorët, përkatësisht me institucionet dhe grupet e interesit ka qenë e hapur dhe transparente. Komunikimi me aktorët është bërë në formë të shkruar.